

PROCESVERBALI
Nga Kuvendi i tetë i Komunitetit Shqiptar të Gjenevës,
i mbajtur me 16 tetor 2023 në Gjenevë

Prezent, anëtarët e kryesisë: Ali Mehmeti, Afërdita Krasniqi, Nasuf Nuhiu, Fadila Avdija, Nebi Hiseni, Fadil Selmani, Lutfi Rexha, Rrezarta Sejdiu-Shatri, Blerim Ibrahim, Blerim Bunjaku, Linda Rexhaj-Maliqi.

Mungon: Mergime Bajrami.

Në ora 19h45, mbledhjen e hapi kryetarja e Komunitetit Shqiptar të Gjenevës znj. Afërdita Krasniqi duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe duke i informuar për programin e mbrëmjes të ndarë në 3 pjesë kryesore:

- Punimet e Kuvendit të tetë të Kshgj-së
- Programi argëtues
- Aperitivi

Zonja Krasniqi i njofton të pranishmit për broshurën e realizuar për nderë të 10 vjetorit të Komunitetit Shqiptar të Gjenevës e punuar nga sekretari Z. Ali Mehmeti, të cilat u ishin në dispozicion për të gjithë të pranishmit.

Ali Mehmeti e merr fjalën ku i përshëndet dhe i falënderon të gjithë të pranishmit si dhe të gjithë anëtarët e kryesisë në mandatet e kaluara ku çdonjërin e falënderon për angazhimet e tyre.

Rëndi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga Kuvendi i Shtatë;
2. Paraqitja e raportit të punës për periudhën ndërmjet dy kuvendeve, diskutimi dhe aprovimi;
3. Paraqitja e Bilancit financiar për vitin 2022, paraqitja e raportit të verifikuesve të kontos për të njëjtin vit, diskutimi dhe aprovimi;
4. Përcaktimi i anëtarëve të kryesisë pas tërheqjes apo/edhe plotësimeve me anëtarë të rinj;
5. Përcaktimi i lartësisë së anëtarësisë;
6. Ndryshimi i Statutit;
7. Zgjedhja e verifikuesve të kontos për vitin 2023;
8. Zgjedhja e Kryetarit-ës të KShGj-së;
9. Të ndryshme.

Pas aprovimit të rëndit të ditës njëzëri, kaluam në piken e parë.

• Aprovimi i proces verbalit nga Kuvendi i shtatë

Procesverbali nga Kuvendi i Shtatë i është dërguar të gjithë anëtarëve të KShGj-së paraprakisht përmes postës elektronike. Nuk pati asnjë vërejtje, ashtu që procesverbali u aprovua njëzëri.

• Paraqitja e raportit të punës për periudhën ndërmjet dy kuvendeve, diskutimi dhe aprovimi

Kryetarja e KShGj znj. Afërdita Krasniqi, paraqiti raportin e punës që përfshin periudhën ndërmjet dy kuvendeve.

- Shfaqja e filmit shqip “Bolero në vilën e pleqve”, në bashkëpunim me FIFOG
- Festa e flamurit e mbajtur më datën 27 nëntor 2022 në Gjenevë
- Vizita e grupit polifonik nga Vlora në mbështetje të Lotarie Romande
- Pjesëmarrja e grupit muzikor “Hareja” në Civita, në Kalabri të Italisë

Nuk pati asnjë vërejtje dhe Raporti i punës u aprovua njëzëri.

- **Paraqitja e Bilancit financiar për vitin 2022, paraqitja e raportit të verifikuesve të kontos për të njëjtin vit, diskutimi dhe aprovim**

Arkëtari, Nasuf Nuhiu, paraqiti Raportin financiar për vitin 2022. Pasi që nuk pati asnjë vërejtje bilanci financiar u aprovua njëzëri.

Gjithashtu arkëtari i falënderoj të gjithë donatorët për kontributet e dhëna gjatë kësaj periudhe dhe në veçanti përmend donatorët :

Besnik Benz, 1000 CHF
Clinique dentaire Frontenex, 1'000 CHF
Lotarie Suisse Romande, 7'000 CHF

Verifikuesit e kontos për vitin 2022, të emëruar në Kuvendin e fundit, paraqitën raportin e kontrollit, të shkruar dhe nënshkruar me 10 maj 2023 duke konstatuar se raporti financiar është në përputhje me Statutin e shoqatës dhe ligjin, prandaj i propozuan Kuvendit ta aprovonjë. Nuk pati asnjë vërejtje dhe raporti i kontrollit u aprovua njëzëri.

- **Përcaktimi i anëtarëve të kryesisë pas tërheqjes apo/edhe plotësimeve me anëtarë të rinj**

Nebi Hyseni, pas aktivitetit 10 vjeçar tërhiqet nga kryesia. Kryetarja e falënderon për aktivitetin e tij. Si anëtarë të rinj u propozuan dhe u pranuan Blerta Murtezi dhe Premton Hajdari. Naser Islami i propozuar nga Nasuf Nuhiu, u sqarua se nuk mund të ushtroi këtë detyrë pasi që është kryetar i kryesisë së degës së LDK-së në Gjenevë, që e ndalon Statuti i KShGj-së. Pra, anëtarët e Kryesisë të KShGj-së për mandatin në vijim janë:

1. Nasuf Nuhiu
2. Ali Mehmeti
3. Afërdita Krasniqi
4. Fadil Avdija
5. Fadil Selmani
6. Rrezarta Sejdiu-Shatri
7. Lutfi Rexha
8. Blerim Bunjaku
9. Blerim Ibrahim
10. Linda Maliqi-Rexhaj
11. Mergime Bajrami
12. Blerta Murtezi
13. Premton Hajdari

- **Përcaktimi i lartësisë së anëtarësisë**

U votua njëzëri që anëtarësia të mbetet 100 fr në vit për familje. Sikurse deri tani, përjashtim bëjnë familjet që janë në asistencë sociale, personat në pension invalidor dhe studentët që janë në Gjenevë pa familje, për të cilët anëtarësia mbetet 20 fr në vit

- **Ndryshimi i Statutit**

Nasuf Nuhiu propozon që të ketë një ndryshim në **nenin 19** të statusit të KShGj-së ku thuhet se kryesia ka më së paku 9 anëtar dhe propozon të ndryshohet në: **kryesia ka më së paku 7 anëtar**.

Ky propozim u pranua me shumicë votash, 1 abstenim dhe 1 votë kundër.

Linda Maliqi propozon që **neni 24** i statusit të KShGj-së të ndryshoj në pjesën ku thuhet se:

Anëtarë të kryesisë mund të janë vetëm ata persona që kanë **“shtetësi zvicerane, që kanë leje të përhershme qëndrimi në Zvicër (viza C ose B)”**, ose që kanë shtetësi të ndonjë vendi të bashkimit evropian, dhe zëvendësohet me:

Anëtarë të kryesisë mund të janë vetëm ata persona që kanë **status të rregulluar në Zvicër** ose që kanë shtetësi të ndonjë vendi të bashkimit evropian. Ky propozim u pranua njëzëri.

- **Zgjedhja e verifikuesve të kontos për vitin 2023**

Kryetarja pyet se a ka vullnetarë, ose që verifikuesit të tanishëm a janë të gatshëm që të vazhdojnë edhe një mandat? Ilir Papazi në cilësinë e verifikuesit disavjeçar thotë se është më e mirë që të ketë persona të ri si verifikues por në rast nevojë shpreh gatishmërinë për të vazhduar mandatin.

Naser Islami propozon Xhavit Islamin si kandidat të ri. Xhavit Islami ankohet së, kinse shoqata Vitia ka qenë e dëmtuar për më shumë rreth 4'000.- gjë të cilën arkëtari i Kshgj-së Nasuf Nuhiu e konsideron si të pa vërtete dhe të pa bazë. Ai e fton shoqatën Vitia që në raste të dyshimit ti drejtohet organeve të drejtësisë dhe të sqarohen në këtë mënyrë.

Nasuf Nuhiu shpjegon se roli i verifikuesve të kontos është të kontrollojnë harxhimet dhe përputhjet me faktuarat. Si verifikues mund të mandatohen anëtarët e Kshgj-së, anëtarë të shoqatave tjera apo persona të tjerë. Pas disa propozimeve që vazhduan, si verifikues të kontos për mandatin e ardhshëm u zgjodhën:

1. Premtin Bytyqi
2. Mirheme Terziu Ibrahim
3. Shaip Deda

8. Zgjedhja e Kryetarit-ës të KShGj-së;

Edhe pse mandati i kryetarit/es të KShGj-së është i kufizuar në dy mandate nga 2 vjet, znj Afërdita Krasniqi ka qëndruar për 6 vjet. Kjo ka ndodhur për shkak të pamundësisë së ushtrimit të funksionit gjatë 2 viteve sa zgjati pandemia e shkaktuar nga virusi covi-19. Zonja Afërdita Krasniqi, pas konsultimit paraprak me anëtarët e kryesisë, propozoi Nasuf Nuhiun si Kryetar të ri të Komunitetit Shqiptar. Nasuf Nuhiu votohet njëzëri si Kryetar i ri i KShGj-së për mandatin dy vjeçar.

Zonja Krasniqi mbajti fjalimin falënderues lidhur me dy mandatet e fundit si Kryetare e Kshgj-së dhe e konsideroj këtë detyrë si një privilegj, nder dhe përgjegjësi. Falënderon anëtarët e shoqatës, sponsorët, anëtarët e kryesisë për mbështetjen e tyre të vazhdueshme dhe në veçanti iniciuesin e kësaj shoqate, sekretarin aktual Ali Mehmetin si një shtyllë kryesore për Komunitetin Shqiptar të Gjenevës që nga themelimi.

Shprehet shumë mirënjohëse për bashkëpunim e shumëfishte me shoqatat tjera në Gjenevë duke veçuar: LAPSH-in, Rinia Kontakt-in dhe Ansambli Gëzuar. Në fund, e falënderon edhe bashkëshortin Shpejtimin për mbështetjen e vazhdueshme .

Afërdita Krasniqi e uron Nasuf Nuhiun për pozitën e re dhe i dëshiron shumë sukses në këtë përgjegjësi. Nasuf Nuhiu e falënderon Kryetaren dhe të pranishmit për besimin e dhënë duke u deklaruar i gatshëm për vazhdimin e këtij misioni në të mirën e gjithë komunitetit tonë në Gjenevë.

Ismet Mjaku shprehë pakënaqësinë lidhur me procesin e zgjedhjes së Kryetarit të shoqatës dhe e konsideron këtë proces jo demokratik. Ai kërkoi që çdo delegat i shoqatës ta këtë të drejtën e kandidimit për Kryetar. Nasuf Nuhiu shpjegon që funksionimi i KshGj-së nuk është i ngjashëm me funksionimin e partive politike dhe që shoqata KShGj përbëhet nga anëtarët dhe jo nga delegatët. Nasuf Nuhiu sqaroi që në bazë të statusit të shoqatës çdo anëtarë në Kuvend ka të drejtë të propozohet për anëtarë të Kryesisë dhe në rast se e merr mandatin 2 vjeçar pastaj e fiton të drejtën e kandidimit për Kryetar-e.

Në vazhdim, sekretari Ali Mehmeti informon që në shoqatë aktualisht janë rreth 200 anëtarë por vetëm 20 nga ata paguajnë anëtarësi. Ai theksoi që nuk e sheh të arsyeshme të zgjidhet Kryetar-e dikush që nuk ka paguar asnjëherë anëtarësi dhe kjo pastaj do të konsiderohej si jo demokratike. Gjithashtu si masë mbrojtëse është edhe fakti se askush pa qenë anëtar i kryesisë së paku një mandat nuk mund të jetë kandidat për Kryetar-e të shoqatës sepse, mund të ketë ndonjë grup i organizuar që në punime të kuvendit të vijë me numër të madh personash dhe ta voton ndonjë person për të qenë Kryetar-e të KShGj së i cili mund të mos vijë me qëllime të ndershme. Pikërisht për të qenë demokratike, anëtarët e kryesisë nuk mund të janë nga një familje, të janë të gjithë nga një regjion apo të janë udhëheqës të ndonjë partie politike. Anëtarët aktual të kryesisë së KShGj-së janë nga viset e ndryshme shqiptare dhe jep detaje për regjionin e secilit anëtarë.

Fjalën e kërkoi Sokol Nuhiu i cili u prezantua si udhëheqës i shoqatës Velekinca në Gjenevë dhe shprehi gatishmëri për bashkëpunim. Ai thekson faktin që behët fjalë për një punë vullnetarë nga të gjithë dhe është i mendimit që ne nuk kemi nevojë që të vendosim pengesa mesh nesh por apelon të jemi më bashkëpunues. Nuk e sheh të arsyeshme që të zgjidhet Kryetar personi i cili asnjëherë nuk ka paguar anëtarësi dhe që nuk është angazhuar asnjëherë nuk kuadër të shoqatës.

Afërdita Krasniqi shpjegon se çdo shoqatë mundet me dërgua një përfaqësues ne mënyre që të jemi sa më shumë dhe të kemi një bashkëpunim të frytshëm. Fton të gjitha shoqatat që e kane vullnetin dhe dëshirën e mirë që ti bashkëngjiten kryesisë së KShGj-se.

Nasuf Nuhiu cek se shoqata është e të gjithëve dhe nuk është pronë individuale e askujt. Falënderon të gjithë përfaqësuesit e shoqatave dhe të klubeve, anëtarët e Kryesisë së mandateve të kaluara dhe asaj aktuale dhe të gjithë kontribuesit të angazhuar në kuadër të kësaj shoqate. Në veçanti ai falënderon Zonjën Afërdita Krasniqi dhe Zotëri Ali Mehmetin për punën, kontributin dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm në rrugëtimin e kësaj shoqate që nga themelimi dhe promovimin e vlerave tona kombëtare në kuadër të shumë aktiviteteve.

Në vazhdim të mbrëmjes, u bë një befasi nga Kryesia e KShGj për Afërditen dhe Aliun e cila u mirëprit më shumë dashamirësi nga ta dhe nga të gjithë të pranishmit.

Punimet e Kuvendit përfunduan rreth orës 20h45. Mbrëmja vazhdoi me program argëtues më pikat e Ansamblit Gëzuar, Grupit Hareja dhe kitaristit Bashkim Krasniqi të shoqëruar nga violinistja Rina Krasniqi.

Në përfundim të mbrëmjes u shtrua edhe një aperitiv.

Procesmbajtëse
Linda Rexhaj-Maliqi

Kryetar
Nasuf Nuhiu